Nga kjo listë mund të hapet një nënfunksion specifik, por nuk mund të shtohet një nënfunksion i ri.

Lista e nënfunksioneve të një funksioni, duhet të shfaqet brenda funksionit përkatës. (shih më sipër).

Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e shtimit të nënfunksioneve të reja, ndryshimin e informacionit për funksionet ekzistuese si dhe fshirjen e funksioneve të shtuar më parë.

Shtimi i nënfunksionit, nga ndërfaqja e funksionit, duhet të bëjë edhe lidhjen automatike te funksionit me nënfunksionin.

Informacioni mbi nënfunksionet mund të organizohet në dy faqe

Për çdo nënfunksion, në faqen e parë, në sistem duhet të ruhen informacionet si më poshtë:

Kodi i funksionit– varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Funksioni - varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Kodi nënfunksion - varg karakteresh (shërben për të siguruar unicitetin e funksionit, dhe është i përcaktuar nga MF)

Nënfunksioni - varg karakteresh

Numër nënfunksioni - varg karakteresh (është i përcaktuar nga MF)

Kategoria – liste (varg karakteresh)

Nënfunksionet duhet të kategorizohen në nënfunksione të qeverisë qendrore ose të qeverisë vendore.

Për çdo nënfunksion, në faqen e dytë, duhet të shfaqet lista e programeve buxhetore të këtij nënfunksioni. Kjo listë duhet të jetë e editueshme. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë një program të ri, të fshijë një program ekzistues, ose të hyjë brenda një programi.

Lista e programeve duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Kodi funksionit (e paeditueshme)
- Funksioni (e paeditueshme)
- Kodi nënfunksionit (e paeditueshme)
- Nënfunksioni (e paeditueshme)
- Kodi programi (e editueshme)
- Programi (e editueshme)
- Etikete programi (e editueshme)

Moduli i pasaportës së programeve buxhetore

Programi buxhetor

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e të gjithë strukturës së programeve buxhetore sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Kur hyjmë te moduli i programeve buxhetore, duhet të shfaqet një listë e programeve buxhetorë të regjistruar. Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si kodi i funksionit, emri i funksionit, kodi i nënfunkcionit, emri i nënfunkcionit, etiketa e programit, kategoria, programi, kodi programit.

Nga kjo listë mund të hapet një program buxhetor specifik, por nuk mund të shtohet një program buxhetor i ri.

Lista e programeve buxhetore të një nënfunkcionit, duhet të shfaqet brenda nënfunkcionit përkatës. (shih më sipër).

Në brendësi të nënfunkcionit, sistemi duhet të ofrojë mundësinë e shtimit të programeve buxhetore të reja, ndryshimin e informacionit për programet buxhetore ekzistuese si dhe fshirjen e programeve buxhetore të shtuar më parë.

Shtimi i programit buxhetor, nga ndërfaqja e nënfunkcionit, duhet të bëjë edhe lidhjen automatike të nënfunkcionit me programin buxhetor.

Informacioni mbi programet buxhetore mund të organizohet si më poshtë:

Kodi i funksionit – varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Funksioni - varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Kodi nënfunkcion varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Nënfunkcioni - varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Kod programi - varg karakteresh (është i përcaktuar nga MF)

Programi - varg karakteresh

Etiketë programi - varg karakteresh (është i përcaktuar nga MF)

E detyrueshme/shtese – Listë (e detyrueshme, shtesë)

Logo – imazh (duhet të ngarkohet nga përdoruesi dhe të përdoret në raportet që do prodhohen nga sistemi)

Prejardhja – Listë (I veti, I deleguar, Transferuar)

Kategoria – Listë (varg karakteresh)

Programet buxhetore duhet të kategorizohen në programe buxhetore të qeverisë qendrore ose të qeverisë vendore.

Përshkrimi programit – (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Për çdo program buxhetor, duhet të shfaqet lista e të dhënave të këtij programi. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të zgjerojë listën e të dhënave të zgjedhura, të heqë një të dhënë ekzistuese, ose të hyjë brenda një të dhëne. Të dhënat mund të përzgjidhen nga lista e totale e të dhënave aktive, të regjistruara në modulin e të dhënave.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Tipi
- Kodi Përshkrimi
- Njësia matëse

Për çdo program buxhetor duhet të shfaqet lista e qëllimeve të këtij programi. Kjo listë duhet të jetë e editueshme. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë një qëllim të ri, të fshijë një qëllim ekzistues, ose të hyjë brenda një qëllimi. Për çdo program buxhetor mund të kemi vetëm një qëllim aktiv.

Lista e qëllimeve duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Kodi programit (e paeditueshme)
- Programi (e paeditueshme)
- Qëllimi (e editueshme)
- Aktiv (e editueshme)

Qëllimi

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e qëllimeve të programeve buxhetore.

Kur hyjmë te moduli i qëllimeve, duhet të shfaqet një listë e qëllimeve të regjistruar. Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si kodi i programit, emri i programit, qëllimi, aktiv ose jo.

Nga kjo listë mund të hapet një qëllim specifik, por nuk mund të shtohet një qëllim i ri.

Lista e qëllimeve të një programevi buxhetor, duhet të shfaqet brenda programit buxhetor përkatës. (shih më sipër).

Në brendësi të programit buxhetor, sistemi duhet të ofrojë mundësinë e shtimit të qëllimeve të reja, ndryshimin e përshkrimit për qëllimet ekzistuese si dhe fshirjen e qëllimeve të shtuar më parë.

Shtimi i qëllimit, nga ndërfaqja e programit buxhetor, duhet të bëjë edhe lidhjen automatike të qëllimit me programin buxhetor.

Informacioni mbi qëllimet mund të organizohet si më poshtë:

Kodi i programi – varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Programi - varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Qëllimi - varg karakteresh

Aktiv – Listë (Aktiv, Joaktiv)

Për çdo qëllim të programit buxhetor duhet të shfaqet lista e objektivave të këtij qëllimi. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë një objektive të re, të fshijë një objektive ekzistuese, ose të hyjë brenda një objektive.

Lista e objektivave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Kodi programit
- Programi
- Qëllimi
- Objektiva
- Aktiv

Objektiva

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e objektivave të qëllimeve të programeve buxhetore.

Kur hyjmë te moduli i objektivave, duhet të shfaqet një listë e objektivave të regjistruar. Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si kodi i programit, emri i programit, qëllimi, objektiva, aktive ose jo.

Nga kjo listë mund të hapet një objektivë specifike, por nuk mund të shtohet një objektivë i ri.

Lista e objektivave të një qëllimi të një programi buxhetor, duhet të shfaqet brenda qëllimit përkatës. (shih më sipër).

Në brendësi të qëllimit, sistemi duhet të ofrojë mundësinë e shtimit të objektivave të reja, ndryshimin e objektivave ekzistuese si dhe fshirjen e objektivave të shtuar më parë.

Shtimi i objektivave, nga ndërfaqja e qëllimit programit buxhetor, duhet të bëjë edhe lidhjen automatike të qëllimit me objektivën.

Informacioni mbi objektivat mund të organizohet si më poshtë:

Kodi i programi – varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Programi - varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Qëllimi - varg karakteresh (automatik, i paeditueshëm)

Objektiva – varg karakteresh

Aktiv – Listë (Aktiv, Joaktiv)

Për çdo objektivë, duhet të shfaqet lista e indikatorëve të kësaj objektive. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të zgjerojë listën e indikatorëve të zgjedhur, të heqë një indikator ekzistues, ose të hyjë brenda një indikatorit. Indikatorët mund të përzgjidhen nga lista e totale e indikatorëve aktivë, të regjistruara në modulën e indikatorëve.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Kod indikatorit
- Emër indikatorit
- Përshkrim indikatorit
- Aktiv ose jo

Moduli i të dhënave

Sistemi duhet të mundësojë krijimin i një repozitorie të dhënash/produktesh, të cilat duhet të zgjidhen për përdorim përgjatë sistemit.

Krijimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet në mënyrë qendrore, duke siguruar kështu standardizim të procesit.

Kur hyjmë te moduli i të dhënave, duhet të shfaqet një listë e të dhënave të regjistruara në sistem.

Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si tipi, kodi, emri, njësia matëse, kategorizimi.

Nga kjo listë mund të hapet një e dhënë ekzistuese, si edhe duhet lejohet mundësia e shtimit të një të dhëne të re.

Në brendësi të ndërfaqjes së të dhënës sistemi duhet të ofrojë mundësinë e fshirjes së të dhënës.

Informacioni mbi të dhënë mund të organizohet si më poshtë:

Tipi – Listë (Produkt, Variabël, Konstante)

Kodi - varg karakteresh (duhet të jete unik)

Emri - varg karakteresh

Njësia matëse – Listë vlerash

Kategorizimi – Listë (varg karakteresh)

Të dhënat duhet të kategorizohen në të dhënestandarde ose jo.

Përshkrimi i të dhënës – (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Moduli i indikatorëve

Sistemi duhet të mundësojë krijimin i nje repozitorie të indikatorësh, të cilët duhet të zgjidhen për përdorim pergjatë sistemit.

Krijimi i këtyre indikatorëve duhet të bëhet në menyrë qëndrore, duke siguruar kështu standardizim të procesit.

Kur hyjmë te moduli i indikatorëve, duhet të shfaqet nje listë e indikatorëve të regjistruar në sistem.

Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si kodi, emri, përshkrimi, tipi matjes, aktiv ose jo.

Nga kjo listë mund të hapet një indikator ekzistues, si edhe duhet lejohet mundësia e shtimit të një indikatorit të ri.

Në brendësi të ndërfaqjes së indikatorit, sistemi duhet të ofroje mundësinë e fshirjes së indikatorit. Informacioni mbi indikatorin mund të organizohet si më poshtë:

Kodi - varg karakteresh (duhet të jete unik)

Aktiv – Listë (Aktiv, joaktiv)

Emri - varg karakteresh

Njësia matëse – varg karakteresh

Formula* – Listë (varg karakteresh)

Përshkrimi i indikatorit– (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Tipi i matjes – Listë (përqindje, vlerë)

Sjellja** – Listë (Neutrale, pozitive, negative)

E dhëna 1 – Përzgjidhet nga lista e të dhënave

E dhëna 2 - Përzgjidhet nga lista e të dhënave

E dhëna 3 - Përzgjidhet nga lista e të dhënave

*Formula do jetë fusha që do të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së vlerës së indikatorit në regjistrimin e tij në vitin përkatës. Shih seksionin më poshtë për listimin e formulave

Sistemi duhet të lejojë lidhjen e indikatorit me të dhënat që do përdoren për përlllogaritjen e tij. Këto lidhje do të behen në ndërfaqen e indikatorit. Në bazë të formulës, një indikator mund të lidhet deri me tre të thëna.

Sjellja** - Kjo fushë shërben për të përcaktuar trendin e indikatorit.

Tabela më poshtë, tregon drejtimin e trendit sipas rasteve.

Vlera e matur\Sjellja	Pozitive	Negative	Neutrale
Në rritje	Rritës	Zbritës	N/A
Në zbritje	Zbritës	Rritës	N/A

Formulat

Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e përdorimit të formulave më poshtë:

- Edhëna1/Edhëna2
- $100 * \text{Edhëna1} / \text{Edhëna2}$
- Edhëna1 diferencë
- Edhëna1 diferencë raport
- E dhëna1
- $\text{Edhëna1} / 365$
- $(\text{Edhëna1} / \text{Edhëna2}) * 100$
- $(\text{Edhëna1} / \text{Edhëna2}) * 1000$
- Edhëna1 - Edhëna2

- Edhëna1 + Edhëna2
- Edhëna1 + Edhëna2 + Edhëna3
- $(\text{Edhëna1} + \text{Edhëna2})/\text{Edhëna3}$
- $\text{Edhëna1}/(\text{Edhëna2} + \text{Edhëna3})$
- Diferencë $(\text{Edhëna1} + \text{Edhëna2})$
- Diferencë raport $(\text{Edhëna1} + \text{Edhëna2})$

Kalkulimi automatik i vlerës së indikatorit, të regjistruar në objektivën e qëllimit të programit buxhetor të versionit të vitit që po raportohet do bëhet duke ndjekur logjikën sim ë poshtë:

Përcaktohet formula për llogaritjen e indikatorit. Më pas, tërhiqen vlerat e regjistruara në sistem për të dhënat e përdorura në formulë. Do të përdoren vetëm të dhënat, të cilat janë matur për programin specific. Nëse një e dhënë e nevojshme sipças formulës, nuk është matur për atë program, atëhere llogaritja nuk mund të bëhet. Sistemi duhet të kontrollojë edhe rastet kur kemi pjestim me 0 ose gabime të ndryshme që mund të vijnë nga llogaritja.

Moduli i viteve financiarë

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e një viti financiar.

Kur hyjmë te moduli i viteve financiarë, duhet të shfaqet një listë e viteve të regjistruar. Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si periudha, viti aktual, viti i shkuar, viti i pritur (aktual+1), viti i pritur (aktual+2), viti i pritur (aktual+3)

Sistemi duhet të ofroje mundësinë e shtimit të viteve të reja, ndryshimin e informacionit për vitet ekzistuese si dhe fshirjen e viteve të shtuar më parë.

Për çdo vit financiar, në sistem duhet të ruhen informacionet si më poshtë:

Viti aktual– numër

Viti minus 2 – numër, Automatik i llogaritur nga sistemi (vit aktual -2)

Viti minus 1 – numër, Automatik i llogaritur nga sistemi (vit aktual -1)

Viti t1 (I prituri) – numër, Automatik i llogaritur nga sistemi (vit aktual + 1)

Viti t2 (I prituri) – numër, Automatik i llogaritur nga sistemi (vit aktual + 2)

Viti t3 (I prituri) – numër, Automatik i llogaritur nga sistemi (vit aktual + 3)

Periudha – varg karakteresh, Automatik e llogaritur nga sistemi (Viti t1 (I prituri) – Viti t3 (I prituri))

Moduli i bashkisë

Sistemi duhet të mundësojë ruajtjen e të dhënave konstante për bashkinë Dimal.

Kur hyjmë te moduli i bashkisë, duhet të shfaqet regjistrimi për bashkinë.

Ndërfaqja e brendshme e bashkisë, mund të organizohet në dy faqe. Në brendësi të faqes së parë, duhet të vendoset informacionet për bashkinë si më poshtë:

Bashkia - varg karakteresh

Qyteti - varg karakteresh

Rruga – varg karakteresh

Kodi postar – varg karakteresh

Tel – varg karakteresh

Fax – varg karakteresh

E-mail – varg karakteresh

Logo – imazh (duhet të ngarkohet nga përdoruesi dhe të përdoret në raportet që do prodhohen nga sistemi)

Harta administrative – imazh (duhet të ngarkohet nga përdoruesi dhe të përdoret në raportet që do prodhohen nga sistemi)

Foto e përgjithshme e qytetit – imazh (duhet të ngarkohet nga përdoruesi dhe të përdoret në raportet që do prodhohen nga sistemi)

Në faqen e dytë duhet të shfaqet lista e viteve financiarë. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë regjistrime të viteve financiarë, të fshijë një regjistrim ekzistues, apo të hyjë brenda një viti financiar.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Bashkia
- Viti
- Periudha

Regjistrimi viteve të ndryshme, do të mundësojë krijimin e historikut për të dhënat e regjistruara, dhe do krijojë mundësinë e krahasimeve të vlerave të regjistruara gjatë viteve të ndryshme.

Moduli i regjistrimeve për një vit financiar

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimet e matjeve në një vit financiar.

Kur hyjmë te moduli i regjistrimeve të viteve financiarë, duhet të shfaqet listë e të gjithë viteve.

Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si viti, periudha.

Ndërfaqja e brendshme e regjistrimit të vitit, mund të organizohet në dy faqe. Në brendësi të faqes së parë, duhet të vendoset informacionet për të dhënat e vitit si më poshtë:

Bashkia - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Qyteti - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Rruga – varg karakteresh(automatik, e paeditueshme)

Kodi postar – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Tel – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Fax – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

E-mail – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Error! Bookmark not defined.Në faqen e dytë duhet të shfaqet lista e versioneve të regjistrimeve për të njëjtin vit financiar.

Bashkia bën regjistrime të ndryshme gjatë vitit, kryesisht në periudha 3 mujore. Përgjatë një viti financiar, duhet të ekzistojë mundësia të krijohen një numër i palimituar versionesh.

Regjistrimi i versioneve të ndryshme do krijojë një historik të vlerave të ndryshme, duke mundësuar kështu analizimin e vlerave dhe ndryshimet e tyre gjate regjistrimit në periudha të ndryshme.

Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë regjistrime versioneve të viteve financiarë, të fshijë një version ekzistues, apo të hyjë brenda një versioni të krijuar më parë.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Bashkia (e paeditueshme)
- Viti (e paeditueshme)
- Periudha (e paeditueshme)
- Version (listë, shih seksionin më poshtë për vlerat e mundshme)
- Datë

Sistemi duhet të mundësojë edhe kopjimin e versioneve në sistem. Duhet të mundësohen dy lloje kopjimesh në sistem:

- 1) Kopjim brenda të njëjtit vit. Në këtë rast, brenda të njëjtit vit, duhet të krijohet një kopje origjinale e të gjithë informacionit që ndodhet i regjistruar në versionin e fundit të të njëjtit vit. Nëse në të njëjtin vit, nuk ka regjistrim të mëparshëm, atëherë versioni i ri nuk krijohet.
- 2) Kopjim nga viti i kaluar. Në këtë rast, krijohet një regjistrim versioni i ri, ku të dhënat kopjohen nga versioni më i fundit i vitit të kaluar. Në këtë rast kopjohen të gjitha fushat tekst, si edhe vlerat në e matshme për vitet e raportuara. Duke qenë që kemi zhvendosje nga njëri vit, në tjetrin, duhet të kihet kujdes në kopjimin e të dhënave, ku vlerat duhet të zhvendosen me një kolonë.

Të dy kopjimet, duhet të kopjojnë çdo informacion për versionin, si edhe për modulet e lidhura me këtë version, si programet buxhetore, projektet, qëllimet, objektivat, të dhënat dhe indikatorët.

Moduli i regjistrimeve të një versioni brenda një viti financiar

Versionet është moduli më I rëndësishëm i sistemit, pasi çdo raportim ka këtë si reference.

Në baze të seksionit më sipër, sistemi duhet të ofrojë krijimin e një version të ri brenda një viti, ose krijimin automatic nga rutinat e ofruara të shpjeguara më sipër.

Kur hyjmë te moduli i versioneveversioneve. Lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si viti, periudha, numri i versionit, data e aktualizimit.

Në këtë element regjistrohen informacione të ndryshme, të cilat do ndihmojnë në ruajtjen e informacionit shumëplanësh të bashkisë. Këto informacione duhet të jenë të studiuara për të prodhuar dokumente të cilat bashkia duhet t'i dorëzojë në Ministrinë e Financave sipas formatit të duhur, bazuar në udhëzimet e nxjerra, dhe sipas afateve të kërkuara.

Sistemi duhet të prodhojë dokumentet e mëposhtme:

IPF – Instrumenti i planifikimit financiar (Identik me formatin Excel e kërkuar nga Ministria)

Relacioni shoqërues (duke ndjekur formatet e këshilluara në udhëzim)

Raporti i performancës (duke ndjekur formatet e këshilluara në udhëzim)

Plani i performancës

(Më poshtë do jenë të shpjeguar të gjithë dokumentet e mësipërm)

Ndërfaqja e brendshme e regjistrimit të versionit, mund të organizohet në disa faqe.

Në brendësi të faqes së parë, duhet të vendoset informacione të përgjithshme si më poshtë:

Bashkia - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Qyteti - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Rruga – varg karakteresh(automatik, e paeditueshme)

Kodi postar – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Tel – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Fax – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

E-mail – varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Viti – numër (automatik, e paeditueshme)

Periudha - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Viti minus 2 - numër (automatik, e paeditueshme)

Viti minus 1 - numër (automatik, e paeditueshme)

Viti Plan T1 - numër (automatik, e paeditueshme)

Viti Plan T2 - numër (automatik, e paeditueshme)

Viti Plan T3 - numër (automatik, e paeditueshme)

Shefi i financës - varg karakteresh

Sipërfaqje – numër më presje

Numri i njesive administrative – numër

Kryetari i bashkisë– varg karakteresh

Foto e kryetarit – imazh i ngarkueshëm

Lista e pjesëmarrësve të këshilit bashkiak – Informacioni i nevojshëm për çdo këshilltar do të jetë emri i plotë, partia, koalicioni, gjinia

Numri i meshkujve në këshill bashkiak – numër

Numri i femrave në këshill bashkiak – numër

Popullsia (Të dhënat sipas CENSUS, dhe e vitit të fundit) – numër

Popullsia sipas regjistrimit civil – numër

Dendësia sipas CENCUS-it – numër

Dendësia sipas regjistrimit civil – numër

Numri i punonjësve (Në fund të vitit të kaluar) - numër

Numri i punonjësve me kohë të plotë (Në fund të vitit të kaluar) - numër

Numri i punonjësve me kohë të pjesshme (Në fund të vitit të kaluar) – numër

Data e aktualizimit – datë

Versioni – listë (varg karakteresh) Sistemi duhet të ketë te parakonfiguar listën (1,2,3,4,5-Raport performance). Kjo listë mund të ndryshohet nga administratori, pa pasur nevojë për programim

Formati i matjes së vlerave - listë (varg karakteresh) Sistemi duhet të ketë te parakonfiguar listën (LEK, 1'000 LEK, 100'000 LEK, 1'000'000 LEK). Kjo listë mund të ndryshohet nga administratori, pa pasur nevojë për programim

Raportimi i projekteve – Te raporti i performancës, kërkohen dy mënyra raportimi i projekteve, në nivel të përgjithshëm ose të grupuar nëpër programe. Kjo fushë duhet të krijojë mundësisë e zgjedhjes:

Detajuar për program

Nivel bashkie

Në brendësi të faqes së dytë, duhet të vendoset informacione të përgjithshme si më poshtë:

Situata e njësisë së qeverisjes qendrore - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Çështjet kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Informacion financiar kryesor - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Orientimi afatgjatë i bashkisë - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Strategjia e zhvillimit - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Sfidat kryesore të zhvillimit – vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Projektet kryesore – formati tabelë, ku kolonat janë:

Projekti – varg karakteresh

Arsyet – varg karakteresh

Përfutuesit – varg karakteresh

Totali i shpenzimeve kapitale Viti T1 – numër (automatik, i paeditueshëm)

Totali i shpenzimeve kapitale Viti T2 - numër (automatik, i paeditueshëm)

Totali i shpenzimeve kapitale Viti T3 - numër (automatik, i paeditueshëm)

Lista e programeve, të cilët kanë investime në të paktëm një vit të pritshëm. Lista duhet të përmbajë fushat :

Kodi programi

Programi

Viti Plan 1

Viti Plan 2

Viti Plan 3

Lista duhet të dalë automatikisht dhe të jetë e paeditueshme. Shumatoret e viteve plan duhet të vendosen te tre fushat me sipër për shpenzimet kapitale.

Ku bazohet PBA: - vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Planifikimi i shpërndarjes së financimeve - vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Synimet e programit buxhetor afatmesëm - vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Planifikimi makro i shpenzimeve - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Baza ligjore për hartimin e raportit të ekzekutimit të buxhetit - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Analiza e realizimit - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Të ardhurat

Të ardhurat e versionit duhet të regjistrojnë informacion në lidhje me parashikimin dhe realizimin e të ardhurave si më poshtë:

Parashikimi

Ku bazohet parashikimi - vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Analize per parashikmin - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Realizimi

Analiza e realizimit të të ardhurave - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Përshkrim i detajuar i realizimit - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Përveç informacionit përshkrues, duhet të ruhet informacioni për çdo tipologji të ardhure. Informacioni i kërkuar do jene vlerat për çdo burim buxhetor për 6 vitet e periudhës, si dhe një mundësi për të regjistruar Faktin e vitit aktual, deri në periudhën e raportimit.

Burimet buxhetore që do të ruhen do te jene:

Kodi	Burimi buxhetor
A	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
A.1	Të ardhura nga taksat lokale
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore
A.1.2.3	Taksa mbi truallin
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
A.1.5	Taksa e tabelës
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore
A.1.7	Taksa e përkohëshme
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2
A.2	Të ardhura nga taksat e ndara
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura
A.2.3	Taksa e rentës minerare
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale
A.2.5	Taksa të tjera
A.3	Të ardhura nga tarifa vendore
A.3.1	Tarifa me menaxhimit te mbetjeve
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin

Dokumentat Standarde të Tenderit

A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e licensave, lejeve e autorizimeve
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura
A.3.5.5	Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendparkime publike
A.3.5.7	Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj
A.3.6.1	Bibloteka
A.3.6.2	Muzeumet
A.3.6.3	Teatri
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve
A.3.6.5	Pallati i sportit
A.3.6.6	Qendra Komunitare
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)
A.3.6.8	Kopshtet
A.3.6.9	Çerdhet
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit
A.3.9	Tarifa e përkohëshme
A.3.10	Tarifa të tjera
A.4	Të ardhurat e tjera
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)
A.4.8	Sekuestre dhe Zhdëmtime
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare
A.4.12	Shitja e aseteve financiare
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme
A.4.14	Të tjera
B	TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
B1	Trasferta e pakushtëzuar
B2	Trasferta e kushtëzuar
B.2.1	Për funksionet e deleguara
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)
B3	Trasferta specifike
C	HUAMARRJA

C.1	Huamarrja afatshkurtë
C.2	Huamarrja afatgjatë
D	TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR
D.1	Trashëgimi pa destinacion
D.2	Trashëgimi me destinacion
Totali	

Shpenzimet

Shpenzimet e përgjithshme duhet të vendosen të grupuar më vete.

Ne këtë faqe duhet të përmbahet informacion mbi kontigjencën dhe fondin rezervë si edhe informacion përshkrues mbi parashikimin dhe realizimin e shpenzimeve.

Kontigjenca dhe fondi rezervë duhet të ruhen në formatin e një tablele, dhe duhet to ruhen vlerat për tre vitet e pritshme.

Të dhënat përshkrues duhet të jenë si më poshtë

Parashikimi

Planifikimi i investimeve kapitale - vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Planifikimi i shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Planifikimi i shpenzimeve të personelit- (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Realizimi

Realizimi i investimeve kapitale - vlera varg karakteresh, të cilat shtohen në një listë

Realizimi i shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Realizimi i shpenzimeve të personelit- (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e plotësimit automatik të teksteve të realizimit si më poshtë:

Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën X mijë lekë. Investimet kanë zënë Y% të shpenzimeve totale buxhetore dhe krahasuar me vitin 2019 pesha e investimeve në buxhet është ulur në masën K%. Investimet janë përqënduar kryesisht në <listë programesh me më shumë shpenzime>.

Shpenzimet korrente, përfshirë edhe shpenzime për paga dhe sigurimet shoqërore të punonjësve të bashkisë janë realizuar në vlerën X mijë lekë. Shpenzimet korrente kanë zënë Y% të shpenzimeve totale buxhetore dhe krahasuar me vitin 2019 pesha e shpenzimeve korrente në buxhet është ulur në masën K%. Realizimi i shpenzimeve të personelit krahasuar me planin e vitit 2020 është në masën P%. Shpenzimet korrente janë përqënduar kryesisht në <listë programesh me më shumë shpenzime>.

Bashkia i buxheton shpenzimet e saj në bazë të programeve buxhetore. Krahas teksteve të përgjithshme mbi shpenzimet, sistemi duhet të shfaqë edhe listën e programve buxhetorë më të cilët ka buxhetuar bashkia.

Bashkia mund të buxhetojë me programe të ndryshme. Këto programe duhet të zgjidhen nga shporta e programeve të regjistruar në modulin e programeve buxhetore.

Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë programe te reja, të fshijë program ekzistues, apo të hyjë brenda një programi të krijuar më parë.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Kodi (e paeditueshme)
- Programi (e paeditueshme)
- Relevant - zgjedhje (po, jo)
- Strategjik - zgjedhje (po, jo)

Informacioni që sistemi duhet të regjistrojë për një modul, do të shpjegohet në modulin e regjistrimit të matjeve të një programi buxhetor i çelur brenda një versioni.

Informacioni financiar suplementar

Në këtë seksion të versionit do të ruhen informacionet e mëposhtme:

1) Treguesi kyç financiarë

Këta janë tregues fiks dhe do kalkulohen automatiksh nga sistemi, pasi të jetë hedhur informacioni i nevojshëm në një version.

Për çdo tregues financiar, duhet të kemi emrin, përshkrimin, si edhe vlerat e treguesit specifik për të gjithë vitet e periudhës që po raportohet. Sistemi duhet të llogarisë gjithashtu edhe flerën e treguesit për faktin e hedhur për vitin aktual.

Treguesit kyc financiarë janë:

Treguesi	Përshkrimi
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të ardhurave	Shpenzimet e përgjithshme / Të ardhurat e përgjithshme
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave	Taksat dhe tarifat lokale / Të ardhurat e përgjithshme
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të ardhurave	Të ardhura nga burimet e veta / Të ardhura përgjithshme
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj të shpenzimeve	Shpenzimet kapitale / Shpenzimet e përgjithshme
Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve të shpenzimeve	Shpenzime korrente / Totali shpenzimeve
Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve	Shpenzimet e personelit / Shpenzimet e përgjithshme
Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave	Huamarrja afatgjatë / Të ardhurat e përgjithshme
Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	Huamarrja afatgjatë / Të ardhurat e veta
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	Detyrime të prapambetura / Të ardhura të përgjithshme
Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	Shpenzimet në politikat sociale / Shpenzimet përgjithshme

2) Informacion i përgjithshëm

Komente për treguesit financiare - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Rreziqe Financiare dhe Fiskale - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Huamarrja - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Detyrimet e prapambetura

Në këtë seksion do të ruhen detyrimet e prapambetura. Informacioni duhet të ruhet në formë tabele, e cila do përmbaje fushat më poshtë:

Kreditori – varg karakteresh

Data e detyrimit - datë

Stoku 2020 (31 tetor) - numër

Amortizimi deri në fund të 2020 - numër

Stoku 2020 (31 dhjetor) - numër

Amortizimi 2021- numër

Stoku 2021- numër

Amortizimi 2022- numër

Stoku 2022- numër

Amortizimi 2023- numër

Stoku 2023- numër

Këtu duhet të ruhen të gjithë detyrimet e prapambetura, si edhe të hidhet planifikimi i zvogëlimit (likuidimit) të detyrimit deri në tre vitet e ardhshme.

Monitorimi i strategjisë

Në këtë seksion do të ruhet lista e masave strategjike. Informacioni duhet të ruhet në formë tabele, e cila do përmbaje fushat më poshtë:

Fusha prioritare – varg karakteresh

Masa Strategjike – varg karakteresh

Statusi i ecurisë – varg karakteresh

Shtojcë e relacionit

Në këtë seksion do të ruhen informacioni mëposhtëm:

Vlerësimi i shpenzimeve të planifikuara - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Përshkrimi i metodologjisë së përlogaritjes së të ardhurave - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Përshkrim mbi planifikimin e fluksit monetar - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Përveç pjesës narrative, fluksi monetar duhet edhe të ruhet në formë tabelle. Tabela dl ketë dy rreshta, një për shpenzimet dhe tjetri për të ardhurat. Vlerat do të regjistrohen për tre vitet e pritshme.

Moduli i regjistrimeve të një programi brenda një versioni të një viti financiar

Në baze të seksionit më sipër, sistemi duhet të ofrojë krijimin e një programi të ri brenda një version, fshirjen e një programi ekzistues si dhe aksesin në ndërfaqen e një programi buxhetor.

Kur hyjmë te moduli i programeve buxhetorë, lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si viti, periudha, numri i versionit, data e aktualizimit, kodi programit, programi.

Në këtë element regjistrohen informacione të ndryshme, të cilat do ndihmojnë në ruajtjen e informacionit për shpenzimet, të ardhurat, të dhënat dhe indikatorët të grupuar nën një qëllim të përbashkët.

Ndërfaqja e brendshme e regjistrimit të programit, mund të organizohet në disa faqe.

Në brendësi të faqes së parë, duhet të vendoset informacione të përgjithshme si më poshtë:

Bashkia - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Viti – numër (automatik, e paeditueshme)

Periudha - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Data e versionit - datë (automatik, e paeditueshme)

Këtu duhet të ekzistojë mundësia e zgjedhjes së programit financiar, nga lista e programeve financiarë të regjistruar në modulën përkatës.

Automatiku, pas përzgjedhjes së programit, duhet të tërhiqen vlerat në fushat më poshtë:

Kodi programit

Emërtimi i programit

Sistemi duhet të lejojë regjistrimin e vlerave si më poshte:

Drejtoria/Departamenti - varg karakteresh

Kryetari i programi - varg karakteresh

Numrin e personelit për vitin aktual si dhe 3 vitet e pritshme.

Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e kategorizimit të programit në relevant ose jo. NJë program nuk është më relevant, kur ai është përdorur në vitet e kaluar, por nuk ka shpenzime vitin aktual apo nuk planifikohet të përdoret në të ardhmen.

Sistemi duhet të mundësojë kategorizimin e programit në strategjik ose jo. Nëse programi është program strategjik, atëherë duhet të plotësohet informacioni në fushën:

Përshkrimi strategjisë - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Gjithashtu sistemi duhet të lejojë shpjegimin për shpjegimin e realizimit të programit. NJë tekst i paracaktuar duhet të mundësohet nga sistemi:

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: <lista programe>t. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për administrimin e bashkisë.

Të ardhurat

Të ardhurat e programit ndahen në dy pjesë: Të ardhura me destinacion dhe Tarifat .

Informacioni mbi tarifën duhet të vendoset në total për secilin vit të periudhës.

Të ardhurat me destinacion, ruhen në total për tre vitet e pare, dhe të detajuar për tre vitet e pritur.

Detajimet për të ardhurat me destinacion do të jenë:

Transferta e kushtëzuar

Trasferta specifike

Tashëgimi me destinacion

Burime të tjera (përfshirë gjokat)

Sistemi duhet të llogarisë totalin e të ardhurave të pritshme për programin dhe ti ruajë ato në sistem.

Shpenzimet

Shpenzimet e programit duhet të grupohen më vete. Shpenzimet ndahen në shpenzime korrente dhe shpenzime.

Shpentimet korrente të detajuara përbehen nga lista më poshtë:

Kodi	Llogaria ekonomike
Pagat	600
Sigurimet Shoqërore	601
Mallra dhe shërbime	602
Subvencione	603
Të tjera transferta korrente të brendshme	604
Transferta korrente të huaja	605
Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët	606
Rezerva	609
Interesa per kredi direkte ose bono	650
Të tjera	69/?

Për çdo llogari ekonomike, duhet të ruhen vlerat për të gjithë vitet e periudhës, vlerën e faktit të realizuar deri në momentin e raportimit si edhe dy vlera të tjera, përkatësisht PBA vjetshme viti aktual dhe Buxheti Fillestar viti aktual, të cialt do përdoren për të gjeneruar anekset.

Sistemi duhet të llogarisë shumatoren e vlerave sips tabelës më sipër.

Shpenzimet kapitale ndahen në Shpenzime kapitale të jashtme dhe Shpenzime kapitale të brendshme. Secila kategori, përbëhet nga 3 nënkategori:

Kodi	Llogaria ekonomike
Kapitale të Patrupëzuara	230
Kapitale të Trupëzuara	231
Transferta Kapitale	232

Sistemi duhet të llogarisë automatikisht sa janë shpenzimet totale të pritshme.

Matje të tjera

Sistemi duhet të llogarisë Shumën e kërkuar neto për çdo vit të periudhës, si dhe faktin e vitit aktual. Shuma neto llogaritet duke zbritur të ardhurat nga shpenzimet, Llogaritja duhet të behet nga sistemi.

Ne këtë faqe duhet të përmbahet informacion mbi të dhëna plotësuese të programit

Angazhimet duhet të ruhen në formatin e një tabele, dhe duhet to ruhen vlerat për tre vitet e pritshme.

Për secilin vit të pritshëm, duhet të krijohet mundësia të regjistrohen shpjegimet teknike.

Së fundmi, duhet të regjistrohen edhe tavanet buxhetore për programin.

Për çdo tavan, regjistrojmë tavanet e detajuara:

Pagat dhe sigurimet shoqërore

Të tjera shpenzime korrente

Shpenzimet kapitale

Tavanet do të regjistrohen vetëm për tre vitet e pritshme. Sistemi duhet të llogarisë totalin e tavaneve dhe ti shfaqë këto toale.

Aktivitetet

Në këtë seksion do të ruhen aktivitet e programit. Informacioni duhet të ruhet në formë tabele, e cila do përmbaje fushat më poshtë:

Aktiviteti – varg karakteresh

Projektet

Bashkia duhet të regjistrojë të gjithë projektet e saj të kategorizuar në programet buxhetore. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë projekte te reja, të fshijë një projekt ekzistues, apo të hyjë brenda një projekti të krijuar më parë.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- Emri i projektit – varg karakteresh
- Viti (e paeditueshme)
- Shfaq në raportin e performancës - zgjedhje (po, jo)

Duke qenë që bashkia mund të ketë një numër të madh projektesh, dhe një pjesë e tyre mund të ketë një vlerë të papërfillshme për tu evidentuar në raport, sistemi duhet të krijojë mundësinë që projekti të mos shfaqet në raportin e performancës, po të përfshihet në një grupim ‘Të tjera’. Informacioni që sistemi duhet të regjistrojë për një projekt, do të shpjegohet në modulën e regjistrimit të projekte të një programi buxhetor i çelur brenda një versioni.

Të dhënat

Bashkia duhet të regjistrojë të gjitha të dhënat e saj të kategorizuar në produkte/konstante/variabla për çdo program buxhetor.

Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shtojë një matje për një të dhënë të re, të fshijë një matje të dhëne ekzistuese, apo të hyjë brenda një matje të dhëne të krijuar më parë.

Lista e të dhënave duhet të ketë kokat si më poshtë:

- E dhëna – përzgjidhet nga shporta e të dhënave të krijuar më lart në modulën përkatës dhe të regjistruar te pasaporta e këtij programi
- Kodi (i paeditueshëm)
- Njësia matëse (e paeditueshme)
- Vlerat e matjeve për çdo vit të periudhës si dhe vlera e faktit deri në momentin e raportimit që projekti të mos shfaqet në raportin e performancës, po të përfshihet në një grupim ‘Të tjera’.

Informacioni që sistemi duhet të regjistrojë për një matje të dhëne, do të shpjegohet në modulën e regjistrimit të matjeve të të dhënave në një programi buxhetor i çelur brenda një versioni.

Projektet

Në baze të seksionit më sipër, sistemi duhet të ofrojë krijimin e një projekti të ri brenda një programi, fshirjen e një projekti ekzistues si dhe aksesin në ndërfaqen e një projekti buxhetor.

Kur hyjmë te moduli i programeve buxhetorë, lista duhet të ofrojë kërkim mbi fushat si viti, periudha, numri i versionit, data e aktualizimit, kodi programit, programi, emri projektit, vlera e kontratës, fillon, mbaron, <vlerat për vitet e periudhës>

Ndërfaqja e brendshme e regjistrimit të projektit, mund të organizohet në disa faqe.

Në brendësi të faqes së parë, duhet të vendoset informacione të përgjithshme si më poshtë:

Bashkia - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Viti – numër (automatik, e paeditueshme)

Periudha - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Data e versionit - datë (automatik, e paeditueshme)

Kodi i programit - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Programi - varg karakteresh (automatik, e paeditueshme)

Këtu duhet të ekzistojë mundësia e plotësimit të fushave të projektit

Kodi projektit - varg karakteresh

Emri i projektit - varg karakteresh

Vlera e kontratës – numër

Vlera e plotë e projektit – numër

Viti fillimit – numër

Viti mbarimit – numër

Vlerat për vitet e periudhës si dhe vlerën e realizimit të periudhës.

Komente - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Sistemi duhet të lejoj kategorizimin e projektin në projekt të huaj ose projekt vendas.

Në faqen e dytë, duhet të regjistrohen informacione përshkruese të projektit, duke na dhënë një fish të projektit:

Situata - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Synimi - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Aktivitet kryesorë - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Rezultatet e pritshme - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Aktorët e mundshëm - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Kontributet e mundshme në projekt - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Periudha e zbatimit – varg karakteresh

Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit - (varg karakteresh, ku të lejohet formatim i ngjashëm me Word)

Në faqen e tretë, do regjistrohet buxheti i projektit për tre vitet e ardhshme.

Për secilin vit, regjistrojme aktivitetet e projektit, si dhe peshën që zë secila kategori ekonomike:

Paga

Sigurime

Operative

Subvencione

Transferta të brendshme

Transferta për individë

Aktive të trupëzuara

Aktive të trupëzuara

Total (fushë e llogaritur, si shumatore)

Të dhënat e programit

Në baze të seksionit më sipër, sistemi duhet të ofrojë krijimin e një matjeje të re për një të dhënë, fshirjen e një matjeje ekzistuese si dhe aksesin në ndërfaqen e një matjeje.

Për çdo matje, duhet të të mundësohet zgjedhja e të dhënës. E dhëna duhet të ekzistojë te shporta e të dhënave, të krijuar në modulën përkatës, e dhëna duhet të jetë aktive si edhe e dhëna duhet të jetë regjistruar te pasaporta e programit.

Pasi zgjidhet e dhëna, duhet të mundësohet plotësimi vlerave për të gjitha vitet e periudhës si dhe vlera e faktit deri në periudhën e raportimit

Treguesit

Sistemi duhet të marrë automatikisht përshkrimin e programit buxhetor dhe përshkrimin e qëllimit, për çdo program në mënyrë automatike.

Sistemi duhet të ofrojë krijimin e një matjeje të re për një të objektivë, fshirjen e një matjeje ekzistuese si dhe aksesin në ndërfaqen e një matjeje.

Për çdo matje, duhet të të mundësohet zgjedhja e të objektivës. Objektiva duhet të jetë aktive si edhe duhet të jetë regjistruar te pasaporta e programit.

Pasi zgjidhet objektiva, sistemi plotëson atomoatiksht një sëtë fushash.

Për çdo objektië, sistemi duhet të ofrojë krijimin e një matjeje të re për një indikator, fshirjen e një matjeje ekzistuesw si dhe aksesin në ndërfaqen e një matjeje.

Për çdo matje, duhet të të mundësohet zgjedhja e indikatorëve. Indikator duhet te ekzistojë te shporta e të indikatorit, të krijuar në moduln përkatës, indikator duhet të jetë aktive si edhe indikator duhet të jetë regjistruar te pasaporta e programit.

Pasi zgjidhet indikator, duhet të mundësohet plotësimi vlerave për të gjitha vitet e periudhës si dhe vlera e faktit deri në periudhën e raportimit.

Gjithashtu sistemi duhet të mundësojë një llogaritje automatike të vlerave të indikatorit. Për këtë përdoret algoritmi më poshtë:

- 1) Përcaktojme formulën e indikatorit
- 2) Përcaktojme cilat janë të dhënat që do nevojiten për kalkulimin e indikatorit.

Të dyja të mësipërmet i gjejmë si informacion të pasaporta e indikatorit.

- 3) Më pas, kontrollojme nëse produktet që duheshin për kalkulimin automatik të indikatorëve janë mbledhur.
- 4) Kontrolli do behet, për çdo indikator të mundshëm, në mënyrë që të marrim të gjithë eksperiencën.

Kalkulimi i indikatorëve bëhet në nivel indikatorit, nivel objektive, nivel versioni. Kalkulimi fshin të dhënat ekzistuese, dhe vendos ato programet standarte.

Algoritmi duhet të gjejë të gjithë indikatorët e mundshëm për tu kalkuluar duke u bazuar te të dhënat e matura dhe në kombinimet e formulave.

Moduli i dokumenteve

Sistemi duhet te mundësojë gjenerimin e një liste dokumentesh me format të paracaktuar, të cilët do përodren për dorëzim te Ministria e Financës, për prezantim para Këshillit Bashkiak si edhe për përdorim të brendshëm.

Lista e dokumentave janë:

- 1) Plani i performancës
- 2) Instrumenti i planifikimit financiar (IPF)
- 3) Relacioni shoqërues.
- 4) Anekset e monitorimit (5 anekse)
- 5) Raporti i performancës

Referohuni dokumentacionit, për të parë template i cili do programohet.

Kërkesat jofunkionale

Sistemi duhet të jetë i bazuar në web dhe të lejojë akses përmes shfletuesit të internetit. Në këtë mënyrë, sistemi mund aksesohet lehtësisht në vende të ndryshme, pa pasur nevojë për instalime të tjera infrastrukturore nga ana e përdoruesi fundor. Gjithashtu, edhe në rast të ndryshimit të kompiuterit, aksesit nuk ndryshon dhe mbetet i njëjtë.

Platforma duhet të garantojë autentikimin e përdoruesve me Përdorues/Fjalëkalim për administratorin e sistemit, ndërsa përdoruesit normale mund të përdorin llogarinë e Facebook apo GMAIL, duke mundësuar kështu realizimin e aksesit pa qenë nevoja e krijimit të një llogari te re. Monitorimi i performancës së bashkisë është një proces që ndryshom shumë shpejt në kohë dhe kjo mund të sjelle në ndryshime. Sistemi duhet të jetë tepër fleksibël dhe të lejojë shtimin e kolonave të reja në ndërfaqet për hedhje të dhënash. Këto shtime duhet të bëhen nga administratori i sistemit, pa përdorur programim

Administratori duhet të ketë mundësinë të shtojë faqe të ndryshme në një proces, dhe për çdo faqe duhet të ketë mundësinë të shtojë fusha ekstra.

Sistemi duhet të ofrojë tipe të ndryshme të dhënash, ku tekst, text area, listë vlerash dhe fusha HTML janë të detyrueshme që duhet ti ketë. Sistemi duhet të ofrojë tipe të ndryshme datash, ku teksti, fusha e tekstit, lista drop down dhe html input field janë të detyrueshme.

Sistemi duhet të mundësojë shtimin e fushave tip Bashkëngjitje, ku përdoruesit fundorë mund të bashkëngjisin dokumente. Për çdo fushë dokument, duhet të zgjidhen formatet e lejuar (word, pdf, xsl, ppt, jpg, png, gif). Sistemi duhet të ruajë një arkivë të dokumentave që fshihen, në moment që një dokument i ri zëvendëson të parin.

Sistemi duhet të suportojë krijimin e rrjedhave të punës. Sistemi duhet të lejojë krijim dhe ndryshim të një rrjedhe pune nga paneli i administratorit, pa nevojën e programimit, përmes një ndërfaqeje.

Çdo rrjedhë pune, duhet të përbehet nga statuse dhe hapa.

Rrjedha e punës duhet të përcaktojë një status fillestar dhe disa statuse përfundimtarë, duke mundësuar kështu analizimin automatik se cilat çështje janë mbyllur.

Siguria është një pikë e rëndësishme. Sistemi duhet të lejojë konfigurimin e roleve dhe përdoruesve (Mundësisht për të shtuar role të reja përdorues të rinj).

